



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:216764

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06094171

**C.nr.1049/21**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË –  
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Robert Tunaj , në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit, Qeveria e Kosovës,MBPZHR,Agjencia Pyjore e Kosovës-DKR-Prizren kundër të paditurit, A. B.A me vendbanim në M, për kompensim dëmi, me datë 28.08.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

(Në bazë të Heqjes Dorë nga Kërkesëpadia)

Refuzohet në tërsi kërkesëpadia e paditësit KEDS Sha me seli në Prishtinë , kundër të paditurit A. A nga M, me të cilën ka kërkuar “ të obligohet paditësi të kontesti kompensim dëmi, në vlerë 189.72 € me kamat ligjore dhe të obligohet i padituri të paguajë shpenzimet procedurale në shumë 20,00€ ”

**A r s y e t i m**

Paditësi Qeveria e Kosovës,MBPZHR,Agjencia Pyjore e Kosovës-DKR-Prizren përmes parashtrës së datës 14.08.2024 e njofton gjykatën që pala e paditur në këtë qështje kontestimore në tërsi ka kompensuar dëmin me datën 08.08.2024. Gjykatës i ka dorëzuar si provë dëftese pagesën e datës 08.08.2024 me numër 01147. Për këtë arsye deklarohet se heq dorë nga kërkesëpadinë në këtë qështje kontestimore,për borgjin, kamatën dhe shpenzimet për taksen gjyqësore prej 20€ .

Pasi që paditësi, ka hequr dorë nga kërkesëpadia në këtë çështje kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 149 par. 1 të LPK-së, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u mor konform nenit 452 par.1 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,  
C.nr.1049/21 dt.28.08.2024**

Gjyqtari  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.